



### KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Sot më datë 20/08/2019, para meje notere Ardjana A. MEDIU, anëtare Dhomës së Noterëve Tiranë, me seli në adresën: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kat 7, u paraqitën personalisht:

#### **Dhuruesi:**

**Z. Gentjan Dervishaj**, shtetas shqiptar, i biri Petrit-it, i datëlindjes 11.07.1990, lindur dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar prej meje i Pasaportës Italiane me Nr. YB0698172, zotërues i 100 % të kuotës në Shoqërinë „Blue Magic” Sh.p.k.

(në vijim referuar si “Dhuruesi”);

dhe

#### **Pranues i Dhurimit:**

**Z. Vikash Lalit Kumar Gandhi**, shtetas Britanik, lindur më 24.12.1985, në Brent dhe banues në Londër, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar prej meje me Pasaportë Britanike me Nr.539306722.

(në vijim referuar si “Pranues i Dhurimit”);

#### Të Përgjithshme

A. Shoqëria “Blue Magic” Sh.p.k, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar sipas Ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr. NIPT-L91912029L, date 12.07.2019.

B. Gentjan Dervishaj, zotëron 100 % të kuotës në Shoqërinë “Blue Magic” Sh.p.k.

I cili në përputhje me Ligjin “per Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë” Nr. 7850 date 29.07.1994, Ligjin nr. 9901 dt 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” dhe në përputhje dhe me Statutin e Shoqërisë “Blue Magic” Sh.p.k.

Kërkuar redaktimin e kontratës së dhurimit të kuotës si më poshtë vijon:

#### Neni 1

##### Objekti

Dhuruesi bie dakort të transferoje nëpërmjet dhurimit në total 90 % të kuotës nga totali i kapitalit që ai zotëron në Shoqërinë “Blue Magic” Sh.p.k, tek Pranuesi i Dhurimit, Z. Vikash Lalit Kumar Gandhi.

#### Neni 2

##### Giendja e Kuotave

Kuota, objekt i kësaj kontrate, është plotësisht e disponueshme, e transferueshme, dhe e lirë nga çdo lloj pengu, hipoteke apo barre tjetër ligjore.

#### Neni 3

##### Deklarimet dhe garancitë

Dhuruesi deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ai zotëron 100 % të kuotës që do të transferohet nëpërmjet dhurimit sipas kësaj Kontrate, dhe ka të drejtën për t'a transferuar këtë kuotë dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Dhuruesi nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Dhuruesi.

Pranuesi i Dhurimit deklaron dhe vërteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate Pranuesi i Dhurimit ka tagra të plota për të pranuar 90 % të kuotës nga Dhuruesi, sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate dhe se



nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Pranuesi i Dhurimit nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Pranuesi i Dhurimit.

#### **Neni 4**

#### **Transferimi i kuotave**

Transferimi i 90 % të kuotës që Dhuruesi zotëron ka efekt të menjëhershëm. Pranuesi i Dhurimit është mbajtësi të drejtave dhe detyrimeve menjëhere pas nënshkrimit të këtij akti dhe rregjistrimit të tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Transferimi i pronësisë mbi 90 % të kuotës së Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kryhet nga Dhuruesi tek Pranuesi i Dhurimit, me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe depozitimin e kontratës së dhurimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Pas transferimit nëpërmjet dhurimit të pronësisë mbi 90 % të kuotës sipas kësaj Kontrate, struktura e zotërimit të kuotës në Shoqërinë "Blue Magic" Sh.p.k do të jetë si vijon:

- Z.Gentjan Drevishaj zotëron 10 % të kuotës në Shoqërinë "Blue Magic" Sh.p.k.
- Z.Vikash Lalit Kumar Gandhi zotëron 90 % të kuotës të Shoqërisë "Blue Magic" Sh.p.k.

#### **Neni 5**

#### **Të drejtat dhe detyrimet**

Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Pranuesit e Dhurimit gëzojnë të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi pjesët e tyre takuese të kuotës së Shoqërinë "Blue Magic" Sh.p.k, të zotëruara në emër të tyre në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 6**

#### **Mosmarrëveshjet**

Mosmarrëveshjet që lindin nga kjo kontratë do të zgjidhen me mirëkuptim nga të dy palët në rast të kundert do të drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

#### **Neni 7**

#### **Gjuha e Kontratës dhe Hyrja në Fuqi**

9.1 Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) ekzemplarë, në gjuhën Shqipe, të gjitha të njëvlershme dhe origjinale, dhe pasi ju lexua palëve në prezencë të perkthyeses së gjuhës angleze Znj.Donatela Spahija, e datëlindjes 03.03.1993, lindur dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e Letërnjoftimit me Nr. 028667993 dhe Nr. Personal J353030560<sub>2</sub>, u nënshkrua rregullisht prej tyre në prezencën time. Akti nënshkruhet dhe prej meje noteres.

9.2 Kontrata hyn në fuqi me nënshkrimin e saj prej palëve.

#### **PALET KONTRAKTUESE**

**DHURUESI**

*Gentjan Drevishaj*

**Perkthyesë:**

*Donatela Spahija*

**PRANUESI I DHURIMIT**

*VIKASH GANDHI*

**NOTERE**

*Ardjana A.Mediu*



**REZULTATET E KËRKIMIT**

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-2019082712118296  
Data e Rezultatit të Kërkimit: 27.08.2019  
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 12:11:08PM  
Lloji i Kërkimit:  
Numri i Dokumentit: D-400-005-456  
Referenca e Përdoruesit:

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0**

GENTJAN PETRIT DERVISHAJ  
BLUE MAGIC SH.P.K.



*Dei Kacaj*